VENDIM
Nr. 230, datë 19.7.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 2" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw (AC)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1888/1 prot., datë 14.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Erseka Solar Park 2" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw (AC), me vendndodhje në Bashkinë Kolonjë, qarku Korçë",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erseka Solar Park 2" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1888 prot., datë 5.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw (AC), me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3310, fshati Starje, Njësia Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c", si dhe për pikën 2.1, germat "b", "d", "e" dhe "f".

- Nga ky aplikim gjithashtu rezulton se duhet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa "a": saktësimet përkatëse në numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetin e instaluar të secilës. Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion teknik mbështetës për deklaratën e saj për jetëgjatësinë e pritshme të centralit prej 35 vjetësh;

- germa "c": miratimin përfundimtar të operatorit të rrjetit për lidhjen e centralit/centraleve me rrjetin elektrik.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw (AC).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti